



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**  
**Departamentit i Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit**

*Adresa: Rruga: "Abdi Toptani" nr. 1, Tiranë;*

*E-mail: klsh.org.al; Web-site: www.klsh.org.al*

Nr.1076/5Prot.

Tiranë, më 21.12.2018

**V E N D I M**

**Nr.192, Datë 14.12.2018**  
**PËR**

**AUDITIMIN E USHTRUAR NË DREJTORINË RAJONALE TË ALUIZNI-t TIRANA-4 "MBI VLERËSIMIN E AKTIVITETIT EKONOMIKO FINANCIAR, PROCEDURAT E SHQYRTIMIT DHE MIRATIMIT TË KËRKESAVE PËR LEGALIZIMIN E NDËRTIMEVE INFORMALE" për periudhën nga data 01.01.2015 deri më datën 30.04.2018.**

Nga auditimi i ushtruar në Drejtorinë Rajonale të Agjencisë të Legalizimit Urbanizimin dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale (Zona-Turistike) Tirana-4 rezultoi që veprimtaria e subjektit të audituar, në drejtim çështjeve që lidhen me vlerësimin e procedurave të shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizim e objekteve informale, nuk ka qenë plotësisht efektive dhe janë konstatuar shkelje dhe parregullsi ligjore, të cilat kanë sjellë si pasojë legalizimi e objekteve në Tirana 4 duke mos respektuar distancat nga bregu i detit, përrenjt, kanale kulluese dhe në intersifikimin e rrugëve, si dhe në shumë raste nuk janë respektuar kushtet dhe kriteret e vendosura në Planet e Përgjithshme vendore të këtyre zonave në miratimet e objekteve mbi lartësit e miratuara, etj.

Pasi u njoha me Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe Projektvendimin e paraqitur nga Grupi i Auditimit të Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, shpjegimet e dhëna nga subjekti i audituar, si dhe vlerësimet mbi objektivitetin dhe cilësinë e auditimit nga Drejtori i Departamentit të mësipërm, Drejtori i Departamentit të Metodologjisë, Standardeve dhe Sigurimit të Cilësisë së Auditimit si dhe Drejtori i Përgjithshëm, në mbështetje të neneve 10, 15, 25 dhe 30, të ligjit nr. 154/2014 miratuar në datën 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit",

**VENDOSA**

**I. Të miratoj Raportin Përfundimtar të Auditimit "Për vlerësimin e aktivitetit ekonomiko-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të kërkesave për legalizimin e ndërtimeve informale" të ushtruar në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t (Zona-Turistike) Tirana-4, sipas**

programit të auditimit nr.1076/1, datë 17/09/2018, për veprimtarinë nga data 01.01.2015 deri më datën 30.04.2018.

II. Të miratoj rekomandimet për përmirësimin e gjendjes dhe të kërkoj marrjen e masave sa vijon;

#### **A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI**

Nga auditimi i kryer në Drejtorinë Rajonale të ALUIZNI-t, Tirana 4 është konstatuar mospërputhje ndërmjet nenit nr.38/1, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, konkretisht VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, i ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, lidhur me legalizimin e ndërtimeve pa leje të ngritura brenda vijës turistike të miratuar.

Kështu, sipas nenit 38/1 të ligjit nr. 482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, përcaktohet që:

*Ndërtimet pa leje, të ngritura brenda kufirit të vijës turistike, u nënshtrohen procedurave të parashikuara në këtë ligj, sipas kriterëve të përcaktuara në instrumentet e planifikimit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.*

Sa më sipër, nuk mund të legalizohen ndërtime informale në kushtet kur këto ndërtime nuk plotësojnë të gjitha kushtet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për planifikimin e territorit. Sipas VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, në Kreun III, pika 6, përcaktohet se:

*Ndërtimet informale të ngritura brenda kufirit të vijës turistike, nëse çënojnë infrastrukturën rrugore, të parashikuara në dokumentet e planifikimit të territorit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi nuk legalizohen.*

Me ndryshimet e bëra me VKM nr.756, datë 26.10.2016, lidhur me legalizimin e ndërtimeve pa leje të ngritura brenda vijës turistike të miratuar, pika 6, është ndryshuar si vijon:

*Ndërtime informale brenda kufirit të vijës turistike, në kuptim të nenit 38/1, të ligjit nr.9482, datë 3.4.2006, “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, janë ato të ngritura brenda “vijës bregdetare” (jashtë qendrave urbane), të miratuar me vendimin nr.1, datë 8.10.2013 të KKT-së. Këto ndërtime u nënshtrohen kriterëve të legalizimit sipas këtij vendimi dhe **projekteve të infrastrukturës rrugore**, të parashikuara në dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit.*

*Përfundimisht, kur nga zbatimi i **projektit të infrastrukturës rrugore** rezulton se ndërtimi informal nuk çënon veprën, atëherë ai legalizohet”.*

Sa më sipër, sipas VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, të ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 6, mund të legalizohen vetëm ndërtimet informale që nuk çënojnë infrastrukturën rrugore të përcaktuara në dokumentet e planifikimit të territorit.

Nga krahasimi i dispozitave të përmendura, vërejmë se ndërsa neni 38/1, i ligjit nr.9482, datë 03.04.2006, lejon legalizimet në zonat turistike në kushtet kur plotësohen të gjitha kondicionet urbanistike të përcaktuara nga instrumentet e rregullimit të territorit, VKM nr.280, datë 01.04.2015 dhe VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 6, **e ngushton krejtësisht spektrin e kondicioneve urbanistike të detyrueshme për kualifikim, duke e kufizuar këtë spektër dhe duke lejuar kryerjen e legalizimeve vetëm në kushtet kur objektet e legalizuara nuk cënojnë infrastrukturën rrugore të miratuara nga studimet urbanistike.**

KLSH i referohet gjithmonë akteve ligjore në hierarkinë e tyre (Kushtetuta, Kodet, Marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara në parlament, ligjet, VKM, Udhezime, etj.), të cilat qëndrojnë të parat në hierarkinë e akteve, prandaj i rekomandojmë DR të ALUIZNI-t, Tirana 4 Tirana 4 në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, të përgatisë materialin për institucionet përkatëse dhe të kërkojë përputhjen e plotë të akteve nënligjore: VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për kriteret, procedurat e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe në lartësi në ndërtimet me leje”, të ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, **lidhur me legalizimin e ndërtimeve pa leje të ngritura brenda vijës turistike të miratuar, pika 6 me nenin 38/1 të ligjit të legalizimit, kjo me qëllim ruajtjen e resurseve turistike nga abuzimi dhe shpërdorimet.**

## **B. MASA ORGANIZATIVE**

**1. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 në të gjitha rastet që i përkasin zonave turistike Velipojë, Shëngjin dhe Golem, ka lëshuar lejet e legalizimit dhe ka përgatitur inventarët e dosjeve përkatëse të paplotësuara me emrin dhe mbiemrin e arkivistit. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në ligjin Nr.9154, date 06.11.2003, “Për Arkivat” (*Trajtuar hollësisht në faqet 26 deri 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandim:** Drejtoria Rajonale ALUIZNI Tirana 4 të marrë masa duke plotësuar inventarin të gjitha dosjeve me emrin mbiemrin dhe nënshkrimin e arkivistit, pasi të kryhet verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje dhe në të ardhmen ky proces të kryhet menjëherë pas lëshimit të lejes së legalizimit dhe arkivimit të dosjeve nga sektori i Arkivit.

**Menjëherë**

**2. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 në të gjitha rastet, në zonat kadastrale Velipojë, Shëngjin dhe Golem, ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale, në kushtet kur në dosje mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë të lëshuara nga njësitë e pushtetit vendor, për ndërtimet informale të legalizuara në territorin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 27, germa “ç” (*Trajtuar hollësisht në faqet 27-88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**2.1.Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale, në kushtet e mungesës së vërtetimit për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë për të gjitha rastet, kur subjekti nuk përjashtohet nga pagesa e taksës sipas këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.

**Në vijimësi**

**3. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t Tirana 4 në të gjitha rastet e legalizimeve në zonat turistike Velipojë, Shëngjin dhe Golem, ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Ndërtesë”, në kushtet kur në proces-verbalin e verifikimit në terren nuk janë përcaktuar objektet (emër mbiemër i pronarit që e disponon) ose rrugë/kanal, etj., si dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim), duke mos plotësuar rubrikat përkatëse sipas formularit të aprovuar.

Këto mungesa, veçanërisht mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky duhet të jetë dokumenti bazë për

verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera digjitale. Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Urdhri nr.766, datë 10.09.2014 dhe Urdhri nr.851, datë 27.05.2015 të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t (*Trajtuar hollësisht në faqet 35-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**3.1.Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale, që në proces-verbalet e verifikimit në terren që do të mbahen, të plotësohet në të gjithë rubrikat dhe ekstremet e përcaktuara sipas formularit, konkretisht të përcaktohen objektet (emër mbiemër i pronarit që e disponon) ose rrugë/kanal, etj., si dhe të shënohen distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përkrahje), pasi mungesa ekëtyre treguesve, veçanërisht mungesa e distancave nga objektet kufitare, e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera digjitale.

**Në vijimësi**

**4.Gjetje:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 në **24 raste**, në Zonat Kadastrale nr. 3072 Velipojë; nr. 3101 Golem; sipas lejeve të legalizimit nr. 700309, datë 11.09.2015; nr. 700308, datë 14.05.2015; nr. 700405, datë 01.09.2015; nr. 700285, datë 24.04.2015, nr. 700473, datë 13.11.2015, nr. 700624, datë 10.08.2015, nr. 700352, datë 14.07.2015, nr. 700613, datë 12.02.2016, nr. 700650, datë 29.02.2016; nr. 701946, datë 22.11.2017; nr. 704089, datë 20.04.2018; nr. 704090, datë 20.04.2018; nr. 704091, datë 20.04.2018; nr. 700649, datë 16.05.2017; nr. 701708, datë 27.06.2017; nr. 701748, datë 27.07.2017; nr. 700345, datë 07.07.2015; nr. 700341, datë 22.06.2015; nr. 700169, datë 23.09.2016; nr. 701293, datë 18.11.2016; nr. 700364, datë 29.07.2015; nr. 700363, datë 26.07.2015; nr. 701973, datë 08.01.2018; nr. 701802, datë 06.09.2017; nr. 701793, datë 31.08.2017; nr. 701369, datë 21.01.2017; nr. 701345, datë 06.01.2017; nr. 701848, datë 02.10.2017; nr. 701629, datë 12.05.2017; nr. 701652, datë 19.05.2017; nr. 701926, datë 09.11.2017; nr. 701987, datë 31.01.2018; ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara janë në një lartësi prej më shumë se 4 kate, **të ndodhura në zona të parashikuara për ndërtime me dendësi të lartë dhe të ulët.**

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 38/1.

-vendimet e KRRTRSH nr.1 dhe nr.2, datë 18.06.2003, studimet urbanistike, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkalim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

Por, sa më sipër nga DR e ALUIZNI-t Tirana 4 nuk rezulton se është shkelur VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje“, të ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 6. Kjo sepse sipas kësaj dispozite të gjithë objektet informale në Tirana 4, të cilat nuk kanë mbivendosje me infrastrukturën rrugore të miratuar me studimet urbanistike legalizohen, pavarësisht nga plotësimi ose jo i kondicioneve të tjera urbanistike, si numri i kateve, etj. Pavarësisht nga kjo, DR e ALUIZNI-t Zona Turistike, ka përgjegjësinë ligjore dhe administrative, pasi nuk ka ndjekur radhën e zbatimit të akteve ligjore, sipas shkallës hierarkike të dispozitave(*Trajtuar hollësisht në faqet 28-90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1.Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen, që në mos të lëshohen leje legalizimi për objekte e ndërtime informale, pa u bërë ndryshimet ligjore për mos rakordimin e tyre dhe që janë kontradiktore në radhën e zbatimit të legjislacionit aktual për këto legalizime.Në kushtet kur në Zonat Turistike Velipojë, Golem, si dhe në te gjitha zonat turistike

që mbulon kjo Drejtori, objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë” janë në një lartësi prej më shumë se 4 kate, të ndodhura në zona të parashikuara për ndërtime me dendësi të lartë dhe të ulët. Në kushtet e ndryshimeve në studimet e miratuara nga KKT, lejet e legalizimit të lëshohen për objektet në lartësi katesh, sipas këtyre studimeve.

**Në vijimësi**

**5.Gjetje:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 në **1 rast** në Zonën e Kadastrave nr.2291, Kryemëdhenj, Golem Kavajë, sipas lejes së legalizimit nr.700341, datë 22.06.2015, për Objekt Social-Ekonomik (USLUGA shpk), për legalizim të shtesave të ndërtimi me leje bazuar në urdhrin nr.36, datë 09.09.2004 “Për shpallje vendimi të Këshillit të Zhvillimit të turizmit”, vendimi nr.140, datë 27.08.2004 për: Miratim veprimtarie të stimuluar dhe dhënie e titullit “Person i stimuluar” subjektit “G” (më pas i ka kaluar shoqërisë U) me objekt: “Ndërtim dhe vënie në punë e kompleksit rezidencial”, para parcelës nr.1, Golem, Kavajë për ndërtime me 4 dhe 5 kate dhe 1 kat bodrum (nën tokë) dhe koeficient shfrytëzimi territorit prej 30 %. Sipas aktit të ekspertizës kompleksi ka patur zgjerime si anësore dhe në lartësi, duke arritur lartësinë 10 kate, në kundërshtim me vendimin e KZHT-së nr.140, datë 27.08.2004 lejon ndërtime deri në 5 kate lartësi.

Koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 88%, në kundërshtim me normativën e caktuar që i lejon deri në 30 % koeficientin e shfrytëzimit, duke tejkaluar me +55 % këtë koeficient, në kundërshtim me vendimin e KZHT-së nr.140, datë 27.08.2004.

Por, sa më sipër nga DR e ALUIZNI-t Tirana 4 siç kemi shpjeguar në Rekomandimin e mësipërm, konstatohet se këto i lejon VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje“, të ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 6. Kjo ka ndodhur, sepse sipas kësaj dispozite të gjithë objektet informale në Tirana 4 të cilat nuk kanë mbivendosje me infrastrukturën rrugore të miratuar me studimet urbanistike, legalizohen, pavarësisht nga plotësimi ose jo i kondicioneve të tjera urbanistike, si numri i kateve, koeficienti i shfrytëzimit të territorit, etj. Pavarësisht nga kjo, DR e ALUIZNI-t Zona Turistike, duhej të ndiqte radhën e zbatimit të akteve ligjore, sipas shkallës hierarkike të dispozitave dhe ngarkohet me përgjegjësi ligjore (*Trajtuar hollësisht në faqet 35 - 90 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1.Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen, për të mos lëshuar leje legalizimi për shtesa në objekte e ndërtime informale, në të gjitha zonat turistike që mbulon kjo Drejtori, për objekte të ndërtuara sipas vendimeve të KZHT-së, për personat e stimuluar dhe miratim veprimtarie të stimuluar, në kushtet e cënimit të lartësisë në kate dhe të koeficientit të shfrytëzimit të territorit, sipas këtyre vendimeve të KZHT-së dhe studimeve të zonave të miratuara me KKT.

**Në vijimësi**

**6. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 në **40 raste**, në Zonat Kadastrale nr. 3072 Velipojë; nr. 3101 Golem; sipas lejeve të legalizimit nr. 700322, datë 16.06.2015; nr. 700334, datë 16.06.2015; nr. 700320, datë 16.06.2015; nr. 700309, datë 11.09.2015; nr. 700308, datë 14.05.2015; nr. 700379, datë 17.08.2018; nr. 700277, datë 23.03.2015; nr. 700405, datë 01.09.2015; nr. 700266, datë 12.02.2015; nr. 700285, datë 24.04.2015; nr. 700265, datë 12.02.2015; nr. 700317, datë 27.05.2015; nr. 700783, datë 26.06.2016; nr. 701820, datë 30.11.2016; nr. 700875, datë 31.05.2016; nr. 700766, datë 11.04.2016; nr. 700764, datë 11.04.2016; nr. 700318, datë 25.05.2015; nr. 700417, datë 11.09.2015; nr. 700402, datë 02.09.2015; nr. 700560, datë 21.01.2016; nr. 700884, datë 02.06.2016; nr. 701095, datë 26.08.2016; nr. 700881, datë 31.06.2016; nr. 701097, datë 30.08.2016; nr. 700844, datë 16.05.2016; nr. 700870, datë 30.05.2016; nr. 700880, datë 31.05.2016; nr. 700868, datë 30.05.2016; nr. 700473, datë 13.11.2015; nr. 700624, datë 10.08.2015; nr. 700460, datë

03.11.2015; nr. 700650, datë 29.02.2016; nr. 704090, datë 20.04.2018; nr. 704091, datë 20.04.2018; nr. 700649, datë 16.05.2017; nr. 700341, datë 22.06.2015; nr. 701301, datë 16.11.2016; nr. 701838, datë 11.05.2016; nr. 701231, datë 31.10.2016; nr. 700169, datë 23.09.2016, nr. 700449, datë 22.10.2015; nr. 700363, datë 26.07.2015; nr. 701802, datë 06.09.2017; nr. 701973, datë 08.01.2018; nr. 701629, datë 12.05.2017; ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur për objektet përkatëse të legalizuara koeficienti i shfrytëzimit të territorit për objektin e legalizuar është mbi 40 % deri 100% të sipërfaqes së ndërtimit krahasuar me sipërfaqen e parcelës ndërtimore, në një kohë që koeficienti i lejuar nuk duhej të kalonte 30 % të parcelës ndërtimore të miratuar me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me çertifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal.

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 ‘Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje’, të ndryshuar, neni 38/1.

-Vendimet e KRRTRSH nr.1 dhe nr.2, datë 18.06.2003, studimet urbanistike, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkallim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

Por, sa më sipër nga DR e ALUIZNI-t Tirana 4 nuk është shkëlur VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje“, të ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 6. Pavarësisht nga kjo, DR e ALUIZNI-t Tirana 4, duhej të ndiqte radhën e zbatimit të akteve ligjore, sipas shkallës hierarkike të dispozitave (*Trajtuar hollësisht në faqet 37 - 87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**6.1.Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale në zonat turistike Velipojë, Golem si dhe në të gjitha zonat turistike që mbulon kjo Drejtori, për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur për objektet përkatëse të legalizuara koeficienti i shfrytëzimit të territorit është mbi 30% -35%, të sipërfaqes së ndërtimit krahasuar me sipërfaqen e parcelës ndërtimore, sipas studimeve të miratuara, si për rastet e përfitimit të parcelës ndërtimore me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal. Në kushtet e ndryshimeve në studimet e miratuara nga KKT, lejet e legalizimit të lëshohen për objektet dhe parcelat ndërtimore duke zbatuar koeficientët e shfrytëzimit të territorit, sipas këtyre studimeve.

#### Në vijimësi

**7. Gjetje:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 në 27 raste, në Zonat e Kadastrave nr. 3072 Velipojë; nr. 3101 Golem, sipas lejeve të legalizimit nr. 700309, datë 11.09.2015; nr. 701820, datë 30.11.2016; nr. 700764, datë 11.04.2016; nr. 700318, datë 25.05.2015; nr. 700402, datë 02.09.2015; nr. 700560, datë 21.01.2016; nr. 701097, datë 30.08.2016; nr. 700473, datë 13.11.2015; nr. 700613, datë 12.02.2016; nr. 700650, datë 29.02.2016; nr. 700649, datë 16.05.2017; nr. 701345, datë 06.01.2017; nr. 701838, datë 11.05.2016; nr. 700823, datë 03.05.2016; nr. 700759, datë 05.04.2016, nr. 700340, datë 26.06.2015, nr. 700449, datë 22.10.2015, nr. 700461, datë 03.11.2015(parc.), nr. 700399, datë 07.09.2015, nr. 700567, datë 28.01.2016, nr. 700564, datë 25.01.2016, nr. 700617, datë 17.02.2016, nr. 700652, datë 20.02.2016 (parc.); nr. 700422, datë 15.09.2015; nr. 700474, datë 16.11.2015; nr. 700424, datë 17.09.2015; nr. 700423, datë 15.09.2015; nr. 700460, datë 03.11.2015; **ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ndodhen të pozicionuara në zona të titulluara: “Brez i Gjelbër” , “Gjelbërim Mbrojtës”, “Park”, “Shërbime Publike”, “Zonë Sportive”, duke shkëlur në gjurmë të objektit dhe sipërfaqes ndërtimore, plotësisht ose pjesërisht, zona të cilat janë të destinuara për rekreativitet, ekologji, aktivitete sportive, hapësira publike, shërbime të tjera nga shteti, në favor të pushuesve, turistëve, etj., bazuar**

**në studimet e kryera, të miratuara me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal.**

Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 38/1.

-vendimet e KRRTRSH nr.1 dhe nr.2, datë 18.06.2003; vendimin për studimet urbanistike, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkalim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Vendimin e KKT nr.20, datë 10.05.2013, “Për miratimin e instrumentit të përgjithshëm vendor, Komuna Golem, Qarku Durrës”, hartës së PPV (Plani i Përgjithshëm vendor), për zonën e Golemit, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkalim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

Por, sa më sipër nga DR e ALUIZNI-t Tirana 4 nuk është shkelur VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje“, të ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 6. Kjo sepse sipas kësaj dispozite të gjithë objektet informale në Tirana 4 të cilat nuk kanë mbivendosje me infrastrukturën rrugore të miratuar me studimet urbanistike, legalizohen, pavarësisht nga plotësimi ose jo i kondicioneve të tjera urbanistike, si pozicionimi në zona të titulluara: “Brez i Gjellbër” , “Gjellbërim Mbrojtës”, “Park”, “Shërbime Publike”, “Zonë Sportive”, etj. Pavarësisht nga kjo, DR e ALUIZNI-t Zona Turistike, duhej të ndiqte radhën e zbatimit të akteve ligjore, sipas shkallës hierarkike të dispozitave (*Trajtuar hollësisht në faqet 31 - 88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**7.1.Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale në zonat turistike Velipojë, Golem, për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ndodhen të pozicionuara në zona të titulluara: “Brez i Gjellbër” , “Gjellbërim Mbrojtës”, “Park”, “Shërbime Publike”, “Zonë Sportive”, **duke shkelur në gjurmë të objektit dhe sipërfaqes ndërtimore, plotësisht ose pjesërisht, zona të cilat janë të destinuara për rekreativitet, ekologji, aktivitete sportive, hapësira publike, shërbime të tjera nga shteti, në favor të pushuesve, turistëve, etj.**, bazuar në studimet e kryera, të miratuara me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal. Në të gjitha Zonat Turistike që mbulon kjo Drejtori, të zbatohen kondicionet e vendosura sipas studimeve të miratuara nga KKT.

**Në vijimësi**

**8.Gjetje:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 në **5 raste**, në Zonën Kadastrale nr. 3101 Golem dhe 3072 Pulaj, Velipojë, sipas lejeve të legalizimit: nr.700764, datë 11.04.2016; nr.700318, datë 25.05.2015; nr.701097, datë 30.08.2016; nr.700844, datë 16.05.2016, nr.701793, datë 31.08.2017; ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ndodhen të pozicionuara në zonën përgjatë brigjeve të Përroit të Leshnicës(Golem) dhe Hidrovorit të Vilunit (Velipojë), ku nga matja e kryer në hartën vektoriale digjitale dhe në hartën vektoriale, u konstatua se legalizimi i objekteve ishin kryer në një distancë më të vogël se 100 m nga brigjet e përroit, me të cilin kufizohet, **distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme**, si për pasurinë “Truall” ashtu edhe për pasurinë “Ndërtesë” të miratuara me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personave ndërtues informal, për rrjedhojë këto objekte nuk duheshin pranuar për legalizim.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 1, pika 2, germa “a”; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84.

VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”, Kreu III, pika 4, germa “dh” dhe Kreu II, pika 2, germa “gj” (*Trajtuar hollësisht në faqet 36 deri 88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**8.1.Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale në zonat turistike Velipojë, Golem dhe në të gjithë zonat që mbulon kjo Drejtori, për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ndodhen të pozicionuara në zonën përgjatë brigjeve të deteve, lumenjve, përrrenjve, liqeneve, lagunave dhe në përgjithësi të të gjithë ujrave territorial në një distancë më të vogël se 100 m nga brigjet e këtyre ujrave territoriale, me të cilat kufizohet, ***distancë brenda së cilës pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme***, si për pasurinë “Truall” ashtu edhe për pasurinë “Ndërtesë” të miratuara me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personave ndërtues informal.

**Në vijimësi**

**9.Gjetje:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 në **12 raste**, në Zonat Kadastrale nr. 3072 Velipojë; nr. 3101 Golem, sipas lejeve të legalizimit: nr. 701829, datë 20.09.2017; nr. 700344, datë 07.07.2015; nr. 700401, datë 02.09.2015, nr. 701629, datë 12.05.2017; nr. 701652, datë 19.05.2017; nr. 701973, datë 08.01.2018; nr. 701848, datë 02.10.2017; nr. 701748, datë 27.07.2017; nr. 700560, datë 21.01.2016; nr. 700402, datë 02.09.2015; nr. 700318, datë 25.05.2015; 700764, dt. 11.04.2016; ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionin “Banesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ndodhen të pozicionuara në zona të titulluara: “Zonë Shërbimesh”(kodi S) , ***“Zonë turistike me intensitet të lartë”***(kodi Sf-5/2), ***“Brez i Gjellbër”***, ***“Zonë e Shërbimeve të Plazhit”***, pra vetëm për funksione social-ekonomike (hotelerie), bazuar në studimet e kryera, të miratuara me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal. Studimi në këto raste nuk parashikon ndërtime me funksione banimi.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 38/1.

-Vendimet e KRRTRSH nr.1 dhe nr.2, datë 18.06.2003; vendimin nr. studimet urbanistike, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkallim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Vendimin e KKT nr.20, datë 10.05.2013, “Për miratimin e instrumentit të përgjithshëm vendor, Komuna Golem, Qarku Durrës”, hartës së PPV (Plani i Përgjithshëm vendor), për zonën e Golemit, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkallim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

Por, sa më sipër nga DR e ALUIZNI-t Tirana 4 nuk është shkëlur VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje“, të ndryshuar me VKM nr.756, datë 26.10.2016, pika 6. Kjo sepse sipas kësaj dispozite të gjithë objektet informale në Tirana 4 të cilat nuk kanë mbivendosje me infrastrukturën rrugore të miratuar me studimet urbanistike, legalizohen, pavarësisht nga plotësimi ose jo i kondicioneve të tjera urbanistike, si funksioni i objekteve sipas zonave: “Zonë Shërbimesh”(kodi S) , “Zonë turistike me intensitet të lartë”(kodi Sf-5/2), “Brez i Gjellbër”, “Zonë e Shërbimeve të Plazhit”, etj. Pavarësisht nga kjo, DR e ALUIZNI-t Zona Turistike, duhej të ndiqte radhën e zbatimit të akteve ligjore, sipas



shkallës hierarkike të dispozitave (*Trajtuar hollësisht në faqet 40 - 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**9.1.Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale në zonat turistike Velipojë, Golem dhe në të gjithë zonat që mbulon kjo Drejtori, për objektet informale në funksionin “Banesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ndodhen të pozicionuara në zona të titulluara: “Zonë Shërbimesh”(kodi S) , “Zonë turistike me intensitet të lartë”(kodi Sf-5/2), “Brez i Gjellbër”, “Zonë e Shërbimeve të Plazhit”, pra vetëm për funksione social-ekonomike (hotelerie), bazuar në studimet e kryera, të miratuara me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal.

## Në vijimësi

**10.Gjetje:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 në **5 raste**, në Zonën Kadastrale nr.3072 Velipojë, ka lëshuar lejet e legalizimit: nr.700342, datë 20.06.2015, nr.700461, datë 03.11.2015, nr.700363, datë 26.07.2015, nr.700381, datë 17.08.2015, nr.700549, datë 22.12.2015 ku u konstatua se janë kryer legalizime të pasurive “Ndërtesë”, dhe statutet juridikë të pasurive të legalizuara të dërguara me shkresë përcjellëse nga ZVRPP-Shkodër, konfirmon pronësinë e truallit dhe ndërtimit (objektit) të legalizuar dhe janë pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar”, pasuri për të cilat janë lëshuar lejet e legalizimit.

-Në dosjet e audituara nuk u gjetën deklaratat noteriale për prishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar” dhe nuk rezultoi të jenë zbatuar procedurat për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore apo qendrore si dhe të njësisve apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi.

Për rrjedhojë, sa më sipër nuk vërtetohet se ndërtimet janë kryer nga qytetarët dhe si të tilla duhej kërkuar plotësim dokumentacioni nga ZVRPP Shkodër ose subjektet informate, për Kartelat e Pasurive të Paluajtshme, para se të lëshoheshin lejet e legalizimit nga DR e ALUIZNI-t, Tirana 4. Sipërfaqja ndërtimore pronë “Shtet”, e vlerësuar me koston mesatare të ndërtimit të banesave për sipërfaqe shfrytëzimi për qytetin e Shkodrës, sipas EKB, që është  $39,533 \text{ lekë/m}^2$ , ku sipas UKM nr.3, datë 28.12.2016 detyrimi llogaritet në **22,433,001 lekë**.

Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, nenet 1, 2, 3.

-VKM nr.756, datë 26.10.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.280, datë 01.04.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe /ose në lartësi, në ndërtime pa leje”, pika 9.

-Udhëzimin e përbashkët të Zyrës QRPP dhe ALUIZNIT, nr.4695 dhe nr.4688, datë 31.05.2016 “Për procedurat e hollësishme të regjistrimit dhe lëshimit të certifikatës së pasurisë së paluajtshme të legalizuar” pikat 6, 8 dhe 12.

-Ligjin nr.7850, datë 29.07.1994, “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar neni 172. Por, megjithatë nga auditimi rezultoi se, sipas HTR-ve përkatëse të ndodhura në dosje si dhe të sjella më pas me observacionet, ka rezultuar se në 5 rastet e përmendura më sipër, ndërtimet e legalizuara kanë një vijë diagonale, pra kanë shenjën konvencionale të përcaktuar në Rregulloren e Brendshme të ZQRPP, mbi bazën e të cilave evidentohen ndërtimet e paligjshme.

Përveç kësaj, nga konfirmimi i dërguar nga ZVRPP Shkodër me shkresë nr.10419/1, datë 06.12.2018, sipas kërkesës së bërë nga DR ALUIZNI-t Tirana 4, nga verifikimi i hartave të vjetra të administruara pranë ZVRPP Shkodër ka rezultuar se në pozicionin e objekteve që janë legalizuar nuk ka patur ndërtime të vjetra (para 1991).

Megjithatë nga DR e ALUIZNI-t Tirana 4 duhej të ishte kërkuar plotësimi i seksionit “E”, të KPP-ve, duke vendosur kufizimin dhe emrin e mbiemrin e subjektit informal që posedon pronën

“Shtet”, në bazë të urdhrimit të nxjerrë nga Regjistruesi i ZVRPP Shkodër, gjë që nuk është kryer nga ZVRPP Shkodër dhe është pranuar nga DR ALUIZNI-t (*Trajtuar hollësisht në faqet 55 - 95 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**10.1. Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen, duke mos lëshuar leje legalizimi për objekte e ndërtime informale në zonat turistike Velipojë, Golem dhe në të gjithë zonat që mbulon kjo Drejtori, për objektet informale në “Ndërtesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara kanë statusin juridikë “Shtet”, në mungesë të deklaratave noteriale për prishje të objektit pronë “Shtet” ose “Pronar i pavërtetuar” dhe të moszbatimit të procedurave për pasqyrimin e gjendjes së objektit “Shtet” apo “Pronar i pavërtetuar”, sipas regjistrimit të pasurive të paluajtshme të njësisë administruese vendore apo qendrore si dhe të njësisive apo institucioneve shtetërore të cilët i kanë këto pasuri në administrim apo pronësi. Në të kundërt nga DR e ALUIZNI-t Tirana 4 të kërkohet plotësimi i seksionit “E”, të KPP-ve, duke vendosur kufizimin dhe emrin e mbiemrin e subjektit informal që posedon pronën “Shtet”, në bazë të urdhrimit të nxjerrë nga Regjistruesi i ZVRPP Shkodër, dhe më pas të lëshohen lejet e legalizimit.

**Në vijimësi**

**11. Gjetje:** DR ALUIZNI ZONAT TURISTIKE në 10 raste, sipas urdhër-shpenzimeve nr. 19, datë 14.05.2015; nr. 53, datë 24.12.2015; nr. 38, datë 08.08.2016; nr. 39, datë 08.08.2016; nr. 51, datë 12.10.2016; nr. 58, datë 15.11.2016; nr. 30, datë 17.05.2017; nr. 40, datë 05.07.2017; nr. 64, datë 26.10.2017; nr. 70, datë 08.11.2017, për shumën e përgjithshme **2,916,537 lekë**, konstatohet se marrja në dorëzim e mallrave, shërbimeve, është bërë në mungesë verifikimit të specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit, mbi bazën e të cilave komisioni duhej të kryente verifikimin fizik të aktiveve në sasi, cilësi dhe çmim. Këto dokumente nuk ndodhen në dosje, kështu që komisioni realisht nuk ka kryer verifikim, duke patur parasysh edhe kontratat e lidhura.

Sipas proces-verbaleve të marrjes në dorëzim, nuk rezultojnë të jenë kryer verifikime, duke përshkruar procedurën e kryer, përshkrimin e veprimeve të kryera, krahasimet e faktit me dokumentacionin e ofertës fituese, si certifikata origjinale dhe cilësi, kryerjen e provave me zgjedhje, fleta analize laboratorike, garanci malli, etj.

Në 6 raste sipas urdhër-shpenzimeve nr.64, datë 26.10.2017; nr.40, datë 05.07.2017; nr.30, datë 17.05.2017; nr.51, datë 12.10.2016; nr.39, datë 08.08.2016; nr.38, datë 08.08.2016; mungonin proces-verbale të marrjes në dorëzim të aktiveve, për verifikimin fizik të sasisë, cilësisë dhe çmimit, referuar faturës tatimore ose kontratës, të mbajtur nga komisioni.

Sa sipër janë në kundërshtim me udhëzimin e MF nr.30, datë 27.12.2011 Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, të ndryshuar, pikat 42-50 (47) (*Trajtuar hollësisht në faqet 55 -88 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**11.1.Rekomandim:** DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 të marrë masa për të ardhmen,të mos kalojë urdhër-shpenzime për likuidim blerje mallra, materiale, kryerje shërbimesh, në kushtet kur marrja në dorëzim e mallrave, shërbimeve, është bërë në mungesë verifikimit të specifikimeve teknike të përcaktuara në dokumentacionin e prokurimit, mbi bazën e të cilave komisioni duhej të kryente verifikimin fizik të aktiveve në sasi, cilësi dhe çmim, pra kur sipas proces-verbaleve të marrjes në dorëzim, nuk rezultojnë të jenë kryer verifikime, duke përshkruar procedurën e kryer, përshkrimin e veprimeve të kryera, krahasimet e faktit me dokumentacionin e ofertës fituese, si certifikata origjinale dhe cilësi, kryerjen e provave me zgjedhje, fleta analize laboratorike, garanci malli, etj. Të mos kalohen urdhër-shpenzimeve në kushtet e mungesës së proces-verbaleve të marrjes në dorëzim të aktiveve, të hartuara nga komisioni përkatës.

**Në vijimësi**

**12.Gjetje:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 (ZonaTuristike ), lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezultojnë se për **839 objekte** nuk është kërkuar vërtetimi, për likuidimin e taksës të

ndikimit në infrastrukturë në vlerën **42,809,911 lekë**, nuk ka bashkëpunim në nivelin e duhur me Drejtorinë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, me Bashkitë Shkodër, Kavajë, Durrës, Ishëm, në kundërshtim me nenin 27, germa (ç) të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar, si dhe me VKM nr.411, datë 19.05.2010 “Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” i ndryshuar, për të cilat duhej të likuidohej taksa e infrastrukturës në vlerën **42,809,911 lekë si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit** (Trajtuar në faqet 23 -25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1.Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 (Zona Turistike) të marrë masa dhe të ndjekë plotësimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të objekteve me lejeve të legalizimit të lëshuara, t'i kërkojë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Bashkisë Shkodër, Kavajë, Durrës, Ishëm, vërtetimet mbi llogaritjen e likuidimit të Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë në vlerën **prej 42,809,911 lekë**. Njëkohësisht, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t të kërkojë pranë ZQRPP që të ushtrojë tagrin e tij ligjor mbi ZVRPP Shkodër, Durrës, Kavajë, Ishëm, për gjetjen e mundësive të detyrimit të qytetarëve dhe subjekteve për të paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë.

**Brenda muajit Mars 2019**

**13. Gjetje:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 (Zona-Turistike ) sipas pasqyrave të paraqitura, për **458 objekte**, ka lëshuar leje legalizimi për objekte, pronarët e të cilave kanë përfituar një sipërfaqe totale **13,136 m<sup>2</sup>** , ndërkohë që duhej të likuidonin për parcelën ndërtimore vlerën **62,300,000 lekë të pa arkëtuar**, e ndare kjo, në vlerën **31,150,000 lekë dhe 31,150,000 letër me vlerë**, pra janë **62,300,000 lekë të pa arkëtuar**, kjo ka ardhur në mungesë të VKM-ve, si dhe mos përputhshmëri me kërkesat e pikës 5 e nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” **me zgjatje të procedurave dhe mos paraqitje të qytetarëve për të likuiduar detyrimin e parcelave ndërtimore, e cila do ketë efekte negative në të ardhurat në buxhetin e shtetit**, veprime në kundërshtim me Urdhrin e dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t me nr.546, datë 20.01.2016 dhe Urdhrin nr.37, datë 19.01.2016, si dhe në kundërshtim me ‘Matricën e procedurave dhe afateve për shqyrtimin administrativ për legalizim, “ pika 6 dhe 7 e kësaj matrice (Trajtuar në faqet 20 – 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1.Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 (Zona-Turistike) në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t, të marrë masa për **458 dosje** dhe të nisë menjëherë shkresat për deklarimin e VKM-ve, me qëllim përshpejtimin në daljen e VKM dhe të likuidimit nga subjektet për ndërtimet informale të vleftës së parcelave ndërtimore prej

**Brenda muajit Shkurt 2019**

**14.Gjetje:** Në shumicën e rasteve “Procesverbali i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesës në ndërtimin me leje”, nuk ka të përcaktuar largësitë e bazës së objektit nga bregu i detit dhe rrugët. Skica fushore pasqyron përmasat e objektit informal, por nuk ka të pasqyruara; ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti deri në kufirin e pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve dhe as largësinë nga bregu i detit apo rrugët. Këto veprime janë në kundërshtim me manualin “Hartimi dhe paraqitja e materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 846, datë 11.10.2012 “Për miratimin e Manualit të hartimit dhe paraqitjes së materialeve grafike (genplan dhe planimetri) të objektit që legalizohet”, i ndryshuar (Trajtuar hollësisht në faqet 100 -115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4, për rastet e konstatuara e në vijim, të marrë masa që të plotësohet “Procesverbali i verifikimit në terren i të dhënave të ndërtimit pa leje/shtesës në ndërtimin me leje”, me largësitë e bazës së objektit nga lumenjtë, përrenjtë, liqenet dhe rrugët nacionale, ndërtimin në raport me kufizimet dhe situatën ndërtimore rreth tij; largësitë nga objekti te kufiri i pronës; largësitë nga pikat ekstreme të pronës dhe objekteve. Në

rastin e mos plotësimit në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ALUIZNI-t Tiranë, t'i kërkojë Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit, që për objektet informale të pajisura me leje legalizimi të fillojë procedurat për shfuqizimin e lejeve të legalizimit, të dhëna në kundërshtim me dispozitat e ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin, integrimin e zonave informale", i ndryshuar, dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**15. Gjetje:** Legalizimi i objekteve informale është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, në rastet si më poshtë:

-Në **6 raste (5 raste në Shëngjin dhe 1 në Golem)** me lejet e legalizimit me nr.700524, datë 26.11.2015, nr.701582, datë 24.04.2017, nr.700563, datë 21.01.2016, nr.700991, datë 18.07.2016, nr.700915, datë 17.06.2016 dhe nr.700995, datë 22.07.2016 **janë legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i detit**, ku nga verifikimi i hartës dixhitale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë **prej 54 m, 75 m, 90 m, 91 m, 95 m dhe 96 m pranë bregut të detit, pra më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash**, veprime këto në kundërshtim me ligjin Nr.111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 84, pika a dhe b, ku citohet:

*"Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet: a) një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit; b) një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m."*

-Në **4 raste**, në Tirana 4 me lejet e legalizimit nr.700355, datë 16.07.2015, nr.700524, datë 26.11.2015, nr.700425, datë 17.09.2015 dhe nr.700995, datë 22.07.2016, janë legalizuar objekte të cilat bien mbi zonën "Brez i gjelbërt" apo "Gjelbërim Mbrojtës" të rrjetit rrugor të planifikuar sipas vendimeve të KRRTSH. Objektet janë legalizuar në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, neni 38/1 "Ndërtimet pa leje, të ngritura brenda kufirit të vijës turistike, u nënshtrohen procedurave të parashikuara në këtë ligj, sipas kritereve të përcaktuara në instrumentet e planifikimit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.", si dhe në kundërshtim me Vendim nr.1, datë 18.06.2003 të KRRTSH dhe Vendim nr.38, datë 10.05.2013 të KRRTSH(*Trajtuar hollësisht në faqet 102 - 113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**15.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 për **10 rastet** e trajtuara më sipër të marrë masa për anulimin ose shfuqizimin e këtyre lejeve të legalizimit, pasi procedura e legalizimit të këtyre objekteve informale dhe pajisja me leje legalizimi, është kryer në kundërshtim me dispozitat e ligjit të legalizimit dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

#### **Menjëherë**

**16.Gjetje:** Në **6 raste**, në Pulaj, Velipojë, me lejet e legalizimit nr.700523, datë 26.11.2015, nr.700394, datë 01.09.2015, nr.700418, datë 14.09.2015, nr.700522, datë 26.11.2015, nr.700419, datë 14.09.2015 dhe nr.700395, datë 01.09.2015, janë legalizuar objekte 5 katëshe + papafingo (hotele) në emër të **subjektit "F" shpk**, të cilat nuk duhet të legalizoheshin sepse në këtë zonë, sipas Vendimit të KRRTSH Nr.1, datë 18.06.2003, **nuk lejohen ndërtime objekte me destinacion hotelerie në më shumë se 4 kate**. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", i ndryshuar, neni 38/1 "Ndërtimet pa leje, të ngritura brenda kufirit të vijës turistike, u nënshtrohen procedurave të parashikuara në këtë ligj, sipas kritereve të përcaktuara në

*instrumentet e planifikimit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.” dhe në kundërshtim me Vendimin e KRRTRSH Nr.1, datë. 18.06.2003.*

**-Në 4 raste**, në Pulaj, Velipojë me lejet e legalizimit nr.700355, datë 16.07.2015, nr.700338, datë 23.06.2015, nr.700339, datë 23.06.2015 dhe nr.700450, datë 22.10.2015, janë legalizuar objektet “Godinë social ekonomike me 5 kate” të cilat nuk duhet të legalizoheshin sepse janë ndërtuar në “Zonë rezidenciale me dendësi të ulët” ku nuk lejohet të ndërtohen objekte më lartësi më shumë se 1-2 kate. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 38/1 dhe Vendimin e KRRTRSH Nr.1, datë 18.06.2003(*Trajtuar hollësisht në faqet 105 - 109 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1.Rekomandimi:**Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 për **10 raste** e trajtuara më sipër, të kërkojë pranë ZVRPP Shkodër kufizimin e pasurive për katet e ndërtuara mbi lartësinë e lejuar me vendimet e KRRTRSH të objekteve të legalizuara.

**Menjëherë**

**17.Gjetje:** Në **1 rast**, me lejen e legalizimit nr.700425, datë 17.09.2015 është dhënë leje legalizimi me sipërfaqe të parcelës ndërtimore prej  $128.48m^2$  mbi 3-fishin e bazës së ndërtimit, në kundërshtim me Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 17, pika 1/a(*Trajtuar hollësisht në faqet 103 -114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**17.1.Rekomandimi:**Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 të kërkojë pranë ZVRPP Shkodër kufizimin e pasurisë për objektin e ndërtuar derisa sipërfaqja e parcelës ndërtimore prej  $128.48m^2$  e dhënë më tepër se 3-fishi të kalojë në pronësi “Shtet”.

**Menjëherë**

**18.Gjetje:** Në **3 raste**, janë dhënë lejet e legalizimit me nr.700355, datë 16.07.2015, nr.700338, datë 23.06.2015 dhe nr.700339, datë 23.06.2015 për objekte me 5 kate ndërkohë që objektet rezultojnë të jenë me 4 kate. Veprime në kundërshtim me VKM nr.437, datë 28.06.2006 “Për përcaktimin e procedurave për mbledhjen, përpunimin dhe administrimin e të dhënave për ndërtimet pa leje, për ngritjen e bazës së të dhënave” sepse fotografitë e bashkëngjitura paraqesin gjendjen ndërtimore vetëm për 4 kate dhe jo për 5 kate(*Trajtuar hollësisht në faqet 103 deri 114 të Raportit të Auditimit*).

**18.1.Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4, të marrë masa që të kërkojë pranë ZVRPP Shkodër kufizimin e pasurive për katin e 5-të të këtyre objekteve.

**Menjëherë**

**19.Gjetje:** Nga Njësia e Prokurimit nuk është bërë përllogaritja e fondit limit e cila duhej bazuar në Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, VKM nr.860, datë 10.12.2014“Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për legalizim”, si dhe VKM nr.589, datë 10.09.2014 “Për përcaktimin e procedurave të evidentimit në terren të objekteve pa leje/shtesave në ndërtimet me leje, të organeve dhe dokumentacionit”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ka asnjë informacion analitik mbi numrin faktik dhe gjendjen reale të ndërtimeve pa leje sipas zonave dhe vetëdeklarimeve të bëra nga individët, ndërtimet sipas zonave, për të dhënë një pasqyrë të qartë se sa % janë ndërtimet informale nga sasia totale e ndërtimeve të evindetuara, në mënyrë që të bëhej një përllogaritje e saktë e fondit limit për zhvillimin e kësaj procedure prokurimi.

Vlera limit e kontratës është barazvlerësuar me fondin në dispozicion dhe nuk është përllogaritur në bazë nevojash (sasia) dhe çmimit. Nevojat janë numri kateve, që do të mbulohej me shërbimin e kërkuar, i cili do të rezultonte mbi bazën e përcaktimit të një numri dosjesh të vetëdeklarimeve

të një apo më shumë blloqeve të ZK mbi bazën e të dhënave të sipërpërmendura, ku do të evidentoheshin katet për çdo objekt sipas llojit.

-Mospërlllogaritja e vlerës limit të kontratës mbi bazën e nevojave të cilat duhet përcaktoheshin si më sipër, është në kundërshtim me nenin 28 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik.

-Kriteret për kualifikim të përcaktuara nga Njësia e Prokurimit nuk janë të plota dhe të qarta, disa prej tyre nuk janë në përputhje me rregullat e prokurimit dhe parimet për konkurrencën e lirë dhe transparencën në procedurat e prokurimit.

-Anëtarët e Njesisë së Prokurimit nuk kanë mbajtur procesverbalin e hapjes së ofertave, në kundërshtim me nenin 64, pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, nenin 52 dhe nenin 12 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar(*Trajtuar hollësisht në faqet 106 -115 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**20.1. Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa që për të gjitha procedurat e prokurimit, të bëhet kërkesa për prokurim nga sektorët përkatës mbi bazën e nevojave; nga Njësia e Prokurimit të bëhet përlllogaritja e saktë e fondit limit mbi bazën e nevojave të argumentuara qartë edhe saktë; hartimi i fondit limit të shoqërohet me dokumentacion justifikues e argumentues, si dhe kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit të hartohen në përputhje me natyrën, objektin e kontratës, por mbi të gjitha të hartohen në mënyrë të tillë që mos të cenojnë parimet e konkurrencës së lirë dhe transparencën në procedurat e prokurimit.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**21.Gjetje:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa dhe te saktësojë në hartat e elektronik ka objekte të cilat kanë shkelur distancat nga bregu i detit dhe **nuk janë përjashtuar nga legalizimi**, me pretendimin se këto objekte do të skualifikohen “kur të përpunohet dosja”. Pra nuk ka ndjekje dhe përputhshmëri me nenin 38, dhe 39 të dispozitave ligjore, të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar, “Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje”,si dhe ligjit 10186, datë 26.11.2009”Për rregullimin e pronësisë mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmi”, i ndryshuar dhe VKM nr.280, datë 01.04.2015 “Për kriteret, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe në lartësi në ndërtimet me leje” i ndryshuar (*Trajtuar hollësisht në faqet 22 - 25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**21.1. Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa dhe te ndjekë të gjitha procedurat e legalizimit dhe të përjashtimit të objekteve të ndërtuara ne kundërshtim me ligjin për legalizimin dhe te beje njoftimin ne institucionet përkatëse.

#### **Menjëherë dhe në vazhdimësi**

**22.Gjetje:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa për proceduesit e objekteve që, **nuk** kanë tërhequr faturat për të përfunduar lejet e legalizimit e objektit në 327 objekte të cilat megjithëse janë njoftuar, nuk janë paraqitur fare pranë Drejtorisë së legalizimit, nga 337 njoftime me postë, nga këto 84 janë kthyer nga posta me mbishkrimin “Ndodhen jashtë shtetit” ndërsa dy nuk kane pranuar te marinë faturat për te likuiduar detyrimet , dhe 251 procedues i kanë mare faturat dhe nuk janë paraqitur fare për të likuiduar detyrimet, pra megjithë procedurën e ndjekur nga Drejtoria e Aluizni-t nuk ka gjetur opsionin e duhur për ti dhënë zgjidhje këtij procesi, duke mos respektuar afatet ligjore dhe kanë përfunduar procesin dhe nuk janë dërguar shkresa të dy herë dhe të interpretohen sanksionet ligjore sipas ligjit nr.67/2014 neni 13 pika 2 (*Trajtuar hollësisht në faqet 22 deri 25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**22.1. Rekomandim:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të ndjekë të gjitha opsionet për proceduesit e objekteve të ndërtuara të

cilat janë në përfundim të procesit të legalizimit sipas ligjit për legalizimin dhe të bëjë njoftimin në instucionet përkatëse.

**Menjëherë dhe në vazhdimësi**

### **C.MASA SHPERBLIM DËMI**

**1.Gjetje nga auditimi:** Në **3 raste**, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion (vërtetim pronësie, fotokopje e kartelës së pasurisë etj) rezulton se objektet kanë destinacionin “Banim”, ndërkohë që lejet e legalizimit janë lëshuar për “aktivitet”. Nuk janë shlyer detyrimet për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjektit ndërtues në vlerën prej 10% të çmimit minimal fiskal, për çdo m<sup>2</sup> sipërfaqe që është bërë ndryshim destinacioni, sipas nenit 43, të Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” e për pasojë objekti nuk duhet të ishte legalizuar. Mosshlyerja e penaliteteve nga ndërtuesit për sipërfaqen shtesë të ndërtuar për të cilën është ndryshuar destinacioni është në vlerën **1,849,766 lekë, që përbën dëm ekonomik për buxhetin e shtetit** (*Trajtuar hollësisht në faqet 100 - 113 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 të marrë masa dhe të kërkojë në rrugë ligjore, arkëtimin e detyrimeve të papaguara për penalitetet për legalizimin e shtesave të subjekteve ndërtuese të cilat kanë bërë ndryshim destinacioni në vlerën totale prej **1,849,766 lekë**, nga këto **206,235 lekë** për subjektin që ka përfituar lejen e legalizimit me nr.700326, datë 10.06.2015, **1,234,199 lekë** për subjektin që ka përfituar lejen e legalizimit me nr.701137, datë 14.09.2016 dhe **409,332 lekë** për subjektin që ka përfituar lejen e legalizimit me nr.700854, datë 18.05.2016.

**Menjëherë**

### **C. MASA DISIPLINORE**

Mbështetur në Kreu IV, neni 11 germa “d” dhe “e” dhe nenet 37, 141, dhe 153 të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr.8085, datë 13.03.1996, ligjin nr.9125, datë 29.07.2003 dhe ligjin nr.136/2015, ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, si dhe në kontratën individuale të punës **ti kërkojmë Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t** vlerësimin e shkallës së përgjegjësisë për çdo punonjës të cituar më poshtë dhe marrjen e masave disiplinore nga “**Vërejtje me shkrim**” deri në “**Largim nga puna**”, për këta punonjës:

- 1. Znj.I.P, Drejtor Drejtorisë dhe Ish-Përgjegjës Hartografisë,**
- 2. Z. D.Z. Përgjegjës i Sektorit të Legalizimit.**
- 3. Znj. I. Gj, specialiste**
- 4. Z. A.S, specialist terreni**
- 5. z. E.M, specialist.**
- 6. z.A. R, specialist**
- 7. z.A.S, specialist**
- 8. Znj. M.Xh, ish-Drejtor aktualisht Drejtor i Shërbimeve në ZQRPP**
- 9. Znj. K.G,ish-Përgjegjës Sektori Legalizimit, aktualisht në detyrë tjetër.**
- 10.z. A.L, ish përgj/Legalizimit, aktualisht në detyrë tjetër.**

Për faktin se:

1.DR e ALUIZNI-t, Tirana 4, në të gjitha rastet, në zonat turistike Velipojë, Shëngjin dhe Golem, ka lëshuar lejet e legalizimit dhe ka përgatitur inventarët e dosjeve përkatëse të paplotësuara me emrin dhe mbiemrin e arkivistit.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9154, datw 06.11.2003, "Për Arkivat".

-Në të gjitha rastet, në zonat kadastrale Velipojë, Shëngjin dhe Golem, ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale, në kushtet kur në dosje mungojnë vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë të lëshuara nga njësitë e pushtetit vendor, për ndërtimet informale të legalizuara në territorin e tyre.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 27, germa "ç.

-Në të gjitha rastet, në zonat turistike Velipojë, Shëngjin, Golem, ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet "Social-Ekonomik" dhe "Ndërtesë", në kushtet kur, përsa i përket pasurive kufitare (të saktësuara në përshkrim), në proces-verbalin e verifikimit në terren nuk janë përcaktuar objektet (emër mbiemër i pronarit që e disponon) ose rrugë/kanal, etj., si dhe nuk janë shënuar distancat nga pasuritë kufitare (të saktësuara në përshkrim), duke mos plotësuar rubrikat përkatëse sipas formularit të aprovuar.

Këto mungesa, vecanërisht mungesa e distancave nga objektet kufitare e kthejnë proces-verbalin e verifikimit në terren në një dokument formal, kur ky është dokumenti bazë për verifikimin e situatës në terren, pavarësisht hartave vektoriale dhe pamjeve të tjera dixhitale.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Urdhri nr.766, datë 10.09.2014 dhe Urdhri nr.851, datë 27.05.2015, të Drejtorit të Përgjithshëm të ALUIZNI-t.

-Në **24 raste**, në Zonat Kadastrale nr.3072 Velipojë; nr.3101 Golem; sipas lejeve të legalizimit nr. 700309, datë 11.09.2015; nr. 700308, datë 14.05.2015; nr. 700405, datë 01.09.2015; nr. 700285, datë 24.04.2015, nr. 700473, datë 13.11.2015, nr. 700624, datë 10.08.2015, nr. 700352, datë 14.07.2015, nr. 700613, datë 12.02.2016, nr. 700650, datë 29.02.2016; nr. 701946, datë 22.11.2017; nr. 704089, datë 20.04.2018; nr. 704090, datë 20.04.2018; nr. 704091, datë 20.04.2018; nr. 700649, datë 16.05.2017; nr. 701708, datë 27.06.2017; nr. 701748, datë 27.07.2017; nr. 700345, datë 07.07.2015; nr. 700341, datë 22.06.2015; nr. 700169, datë 23.09.2016; nr.701293, datë 18.11.2016; nr. 700364, datë 29.07.2015; nr. 700363, datë 26.07.2015; nr. 701973, datë 08.01.2018; nr. 701802, datë 06.09.2017; nr. 701793, datë 31.08.2017; nr. 701369, datë 21.01.2017; nr. 701345, datë 06.01.2017; nr. 701848, datë 02.10.2017; nr. 701629, datë 12.05.2017; nr. 701652, datë 19.05.2017; nr. 701926, datë 09.11.2017; nr. 701987, datë 31.01.2018; ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet "Social-Ekonomik" dhe "Banesë", në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara janë në një lartësi prej më shumë se 4 kate, të ndodhura në zona të parashikuara për ndërtime me dëndësi të lartë dhe të ulët.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 38/1.

-vendimet e KRRTRSH nr.1 dhe nr.2, datë 18.06.2003, studimet urbanistike, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkallim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Në 1 rast, në Zonën Kadastrale nr.2291, Kryemëdhenj, Golem Kavajë, sipas lejes së legalizimit nr.700341, datë 22.06.2015, për Objekt Social-Ekonomik (U shpk), për legalizim të shtesave të ndërtimi me leje bazuar në udhri nr.336, datë 09.09.2004 "Për shpallje vendimi të Këshillit të Zhvillimit të turizmit", vendimi nr.140, datë 27.08.2004 për: Miratim veprimtarie të stimuluar dhe dhënie e titullit "Person i stimuluar" subjektit "G" (më pas i ka kaluar shoqërisë U) me objekt: Ndërtim dhe vënie në punë e kompleksit rezidencial, para parcelës nr. 1, Golem, Kavajë për ndërtime me 4 dhe 5 kate dhe 1 kat bodrum (nën tokë) dhe koeficient shfrytëzimi territori prej 30 %



Sipas aktit të ekspertizës kompleksi ka patur zgjerime si anësore dhe në lartësi, duke arritur lartësinë 10 kate, në kundërshtim me vendimin e KZHT-së nr.140, datë 27.08.2004 lejon ndërtime deri në 5 kate lartësi.

Koeficienti i shfrytëzimit të territorit është 88%, në kundërshtim me, i cili lejon deri në 30 % koeficienti i shfrytëzimit, duke tejkalluar me 55 % këtë koeficient, në kundërshtim me vendimin e KZHT-së nr.140, datë 27.08.2004.

-Në **40 raste**, në Zonat Kadastrale nr. 3072 Velipojë; nr. 3101 Golem; sipas lejeve të legalizimit nr. 700322, datë 16.06.2015; nr. 700334, datë 16.06.2015; nr.700320, datë 16.06.2015; nr. 700309, datë 11.09.2015; nr. 700308, datë 14.05.2015; nr. 700379, datë 17.08.2018; nr. 700277, datë 23.03.2015; nr. 700405, datë 01.09.2015; nr. 700266, datë 12.02.2015; nr. 700285, datë 24.04.2015; nr. 700265, datë 12.02.2015; nr. 700317, datë 27.05.2015; nr. 700783, datë 26.06.2016; nr. 701820, datë 30.11.2016; nr. 700875, datë 31.05.2016; nr. 700766, datë 11.04.2016; nr. 700764, datë 11.04.2016; nr. 700318, datë 25.05.2015; nr. 700417, datë 11.09.2015; nr. 700402, datë 02.09.2015; nr. 700560, datë 21.01.2016; nr. 700884, datë 02.06.2016; nr. 701095, datë 26.08.2016; nr. 700881, datë 31.06.2016; nr. 701097, datë 30.08.2016; nr. 700844, datë 16.05.2016; nr. 700870, datë 30.05.2016; nr. 700880, datë 31.05.2016; nr. 700868, datë 30.05.2016; nr. 700473, datë 13.11.2015; nr. 700624, datë 10.08.2015; nr. 700460, datë 03.11.2015; nr. 700650, datë 29.02.2016; nr. 704090, datë 20.04.2018; nr. 704091, datë 20.04.2018; nr. 700649, datë 16.05.2017; nr. 700341, datë 22.06.2015; nr. 701301, datë 16.11.2016; nr.701838, datë 11.05.2016; nr. 701231, datë 31.10.2016; nr. 700169, datë 23.09.2016, nr.700449, datë 22.10.2015; nr. 700363, datë 26.07.2015; nr. 701802, datë 06.09.2017; nr. 701973, datë 08.01.2018; nr. 701629, datë 12.05.2017; ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur për objektet përkatëse të legalizuara koeficienti i shfrytëzimit të territorit për objektin e legalizuar është mbi 40 % deri 100% të sipërfaqes së ndërtimit krahasuar me sipërfaqen e parcelës ndërtimore, në një kohë që koeficienti i lejuar nuk duhej të kalonte 30 % të parcelës ndërtimore të miratuar me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 38/1.

-vendimet e KRRTRSH nr.1 dhe nr.2, datë 18.06.2003, studimet urbanistike, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkallim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Në **27 raste**, në Zonat Kadastrale nr. 3072 Velipojë; nr. 3101 Golem, sipas lejeve të legalizimit nr. 700309, datë 11.09.2015; nr. 701820, datë 30.11.2016; nr. 700764, datë 11.04.2016; nr. 700318, datë 25.05.2015; nr. 700402, datë 02.09.2015; nr. 700560, datë 21.01.2016; nr. 701097, datë 30.08.2016; nr. 700473, datë 13.11.2015; nr. 700613, datë 12.02.2016; nr. 700650, datë 29.02.2016; nr. 700649, datë 16.05.2017; nr. 701345, datë 06.01.2017; nr.701838, datë 11.05.2016; nr. 700823, datë 03.05.2016; nr. 700759, datë 05.04.2016, nr. 700340, dt. 26.06.2015, nr.700449, datë 22.10.2015, nr. 700461, datë 03.11.2015(parc.),, nr. 700399, datë 07.09.2015, nr. 700567, datë 28.01.2016, nr. 700564, datë 25.01.2016, nr. 700617, datë 17.02.2016, nr. 700652, datë 20.02.2016(parc.); nr. 700422, datë 15.09.2015; nr. 700474, datë 16.11.2015; nr. 700424, datë 17.09.2015; nr. 700423, datë 15.09.2015; nr. 700460, datë 03.11.2015; ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ndodhen të pozicionuara në zona të titulluara: “Brez i Gjelbërt”, “Gjelbërim Mbrojtës”, “Park”, “Shërbime Publike”, “Zonë Sportive”, duke shkelur në gjurmë të objektit dhe sipërfaqes ndërtimore, plotësisht ose pjesërisht, zona të cilat janë të destinuara për rekreativitet, ekologji, aktivitete sportive, hapësira publike, shërbime të tjera nga shteti, në favor të pushuesve, turistëve, etj.,

bazuar në studimet e kryera, të miratuara me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 38/1.

-vendimet e KRRTRSH nr.1 dhe nr.2, datë 18.06.2003; vendimin nr. studimet urbanistike, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkallim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Vendimin e KKT nr.20, datë 10.05.2013, "Për miratimin e instrumentit të përgjithshëm vendor, Komuna Golem, Qarku Durrës", hartës së PPV (Plani i Përgjithshëm vendor), për zonën e Golemit, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkallim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Në 5 raste, në Zonën Kadastrale nr. 3101 Golem dhe 3072 Pulaj, Velipojë, sipas lejeve të legalizimit: nr. 700764, datë 11.04.2016; nr. 700318, datë 25.05.2015; nr. 701097, datë 30.08.2016; nr. 700844, datë 16.05.2016, nr. 701793, datë 31.08.2017; ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet "Social-Ekonomik" dhe "Banesë", në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ndodhen të pozicionuara në zonën përgjatë brigjeve të Përroit të Leshnicës(Golem) dhe Hidrovorit të Vilunit (Velipojë), ku nga matja e kryer në hartën vektoriale dixhitale dhe në hartën vektoriale, u konstatua se legalizimi i objekteve ishin kryer në një distancë më të vogël se 100 m nga brigjet e përroit, me të cilin kufizohet, distancë brenda së cilës *pasuria shtetërore është e patjetërsueshme dhe e paparashkrueshme*, si për pasurinë "Truall" ashtu edhe për pasurinë "Ndërtesë" të miratuara me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personave ndërtues informal, për rrjedhojë këto objekte nuk duheshin pranuar për legalizim.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.111/2012, datë 15.11.2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", neni 1, pika 2, germa "a"; neni 4, pika 8; neni 5 dhe neni 84.

VKM nr.280, datë 01.04.2015 "Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje", Kreu III, pika 4, germa "dh" dhe Kreu II, pika 2, germa "gj".

-Në 12 raste, në Zonat Kadastrale nr. 3072 Velipojë; nr. 3101 Golem, sipas lejeve të legalizimit: nr.701829, datë 20.09.2017; nr.700344, datë 07.07.2015; nr.700401, datë 02.09.2015, nr.701629, datë 12.05.2017; nr.701652, datë 19.05.2017; nr.701973, datë 08.01.2018; nr.701848, datë 02.10.2017; nr.701748, datë 27.07.2017; nr.700560, datë 21.01.2016; nr.700402, datë 02.09.2015; nr.700318, datë 25.05.2015; nr.700764, dt. 11.04.2016; ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionin "Banesë", në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ndodhen të pozicionuara në zona të titulluara: "Zonë Shërbimesh"(kodi S) , "Zonë turistike me intensitet të lartë"(kodi Sf-5/2), "Brez i Gjelbërt", "Zonë e Shërbimeve të Plazhit", pra vetëm për funksione social-ekonomike (hotelerie), bazuar në studimet e kryera, të miratuara me leje legalizimi, me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal. Studimi në këto raste nuk parashikon ndërtime me funksione banimi.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 3.4.2006 "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje", të ndryshuar, neni 38/1.

-vendimet e KRRTRSH nr.1 dhe nr.2, datë 18.06.2003; vendimin nr. studimet urbanistike, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkallim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Vendimin e KKT nr.20, datë 10.05.2013, "Për miratimin e instrumentit të përgjithshëm vendor, Komuna Golem, Qarku Durrës", hartës së PPV (Plani i Përgjithshëm vendor), për zonën e Golemit, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e

objekteve, në tejkalim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Në 8 raste, në Zonat Kadastrale nr.3072 Velipojë; nr.3101 Golem, sipas lejeve të legalizimit: nr. 700881, datë 31.06.2016(objekti); nr. 700473, datë 13.11.2015(parcela); nr. 700352, datë 14.07.2015(parcela);nr. 704633, datë 16.05.2017(parcela);nr. 701369, datë 21.01.2017(parcela); nr. 700384, datë 18.08.2015 (objekti); nr. 700371, datë 20.10.2015(objekti), nr. 700652, datë 20.02.2016(parcel.); nr. 700461, datë 03.11.2015(parcel.), nr. 700460, datë 03.11.2015 Parc.);ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale në funksionet “Social-Ekonomik” dhe “Banesë”, në kushtet kur objektet përkatëse të legalizuara ose parcelat ndërtimore përkatësendodhen të pozicionuara në zona *me intersektim me rrjetin rrugor*, bazuar në studimet e kryera,me kontratë blerje nga shteti ose me certifikatë pronësie në favor të personit ndërtues informal. Studimi në këto raste nuk parashikon ndërtime me funksione banimi.

*Këto veprime janë në kundërshtim me përcaktimet ligjore e nënligjore të bëra në:*

-Ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, të ndryshuar, neni 38/1.

VKM nr.280, datë 1.4.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje”, pika 6.

-vendimet e KRRTRSH nr.1 dhe nr.2, datë 18.06.2003; studimet urbanistike, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkalim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Vendimin e KKT nr.20, datë 10.05.2013, “Për miratimin e instrumentit të përgjithshëm vendor, Komuna Golem, Qarku Durrës”, hartës së PPV (Plani i Përgjithshëm vendor), për zonën e Golemit, rregulloret dhe hartat e nxjerra sipas këtyre vendimeve, lidhur me legalizimin e objekteve, në tejkalim të numrit të kateve, të lejuara në studimet e bëra për zonat dhe fshatrat turistike.

-Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 (Zona Turistike), lidhur me taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se për **839 objekte** nuk është kërkuar vërtetimi, për likuidimin e taksës të ndikimit në infrastrukturë në vlerën **42,809,911 lekë**, nuk ka bashkëpunim në nivelin e duhur me Drejtoritë e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Njësive të Vetëqeverisjes Vendore, me Bashkitë Shkodër,Kavajë,Durrës,Ishëm, në kundërshtim me nenin 27, germa (ç) të ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 i ndryshuar, si dhe me VKM nr.411, datë 19.05.2010 “Për kriteret, procedurat dhe tipin e formularit të lejes së legalizimit” i ndryshuar, për të cilat duhej të likuidohej taksa e infrastrukturës në **vlerën 42,809,911 lekë si e ardhur e munguar në buxhetin e shtetit (Trajtuar në faqet 23 -25 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)**.

-Drejtoria e ALUIZNI-t Tirana 4 (Zona-Turistike ) sipas pasqyrave të paraqitura, për 458 objekte, ka lëshuar leje legalizimi për objekte, pronarët e të cilave kanë përfituar një sipërfaqe totale 13,136 m<sup>2</sup>, ndërkohë që duhej të likuidonin për parcelën ndërtimore vlerën **62,300,000 lekë të pa arkëtuar**, e ndare kjo, në vlerën **31,150,000 lekë dhe 31,150,000 letër me vlerë,pra janë 62,300,000 lekë të pa arkëtuar**, kjo ka ardhur në mungesë të VKM-ve, si dhe mos përputhshmëri me kërkesat e pikës 5 e nenit 17 të ligjit nr.9482, datë 03.04.2016 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje” **me zgjatje të procedurave dhe mos paraqitje të qytetarëve për të likuiduar detyrimin e parcelave ndërtimore, e cila do ketë efekte negative në të ardhurat në buxhetin e shtetit**,veprime në kundërshtim me Urdhrin e dhënë nga Drejtori i Përgjithshëm i ALUIZNI-t me nr. 546, datë 20.01.2016 dhe Urdhrin nr. 37, datë 19.01.2016, si dhe në kundërshtim me ‘Matricën e procedurave dhe afateve për shqyrtimin administrativ për legalizim, “ pika 6 dhe 7 e kësaj matrice (Trajtuar në faqet 20 – 24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

-DR e ALUIZNI-t, Tirana 4 **në të gjitha rastet**, në zonat kadastrale Velipojë, Shëngjin dhe Golem, ka lëshuar lejet e legalizimit për objektet informale, në kushtet kur në dosje mungojnë

vërtetimet për likuidimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë të lëshuara nga njësitë e pushtetit vendor, për ndërtimet informale të legalizuara në territorin e tyre.

-Në 4 raste, në Tirana 4 me lejet e legalizimit nr.700355, datë 16.07.2015, nr.700524, datë 26.11.2015, nr.700425, datë 17.09.2015 dhe nr.700995, datë 22.07.2016, janë legalizuar objekte të cilat bien mbi zonën “Brez i gjelbërt” apo “Gjelbërim Mbrojtës” të rrjetit rrugor të planifikuar sipas vendimeve të KRRTSH. Objektet janë legalizuar në kundërshtim me ligjin nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 38/1 “Ndërtimet pa leje, të ngritura brenda kufirit të vijës turistike, u nënshtrohen procedurave të parashikuara në këtë ligj, sipas kritereve të përcaktuara në instrumentet e planifikimit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.”, si dhe në kundërshtim me Vendim nr.1, datë 18.06.2003 të KRRTSH dhe Vendim nr.38, datë 10.05.2013 të KRRTSH(*Trajtuar hollësisht në faqet 102 deri 113 të Raportit të Auditimit*).

- Në 6 raste, në Pulaj, Velipojë, me lejet e legalizimit nr.700523, datë 26.11.2015, nr.700394, datë 01.09.2015, nr.700418, datë 14.09.2015, nr.700522, datë 26.11.2015, nr.700419, datë 14.09.2015 dhe nr.700395, datë 01.09.2015, janë legalizuar objekte 5 katëshe + papafingo (hotele) në emër të subjektit “Fishta 2” shpk, të cilat nuk duhet të legalizoheshin sepse në këtë zonë, sipas Vendimit të KRRTSH Nr.1, datë 18.06.2003, nuk lejohen ndërtime objekte me destinacion hotelerie në më shumë se 4 kate. Veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, neni 38/1 “Ndërtimet pa leje, të ngritura brenda kufirit të vijës turistike, u nënshtrohen procedurave të parashikuara në këtë ligj, sipas kritereve të përcaktuara në instrumentet e planifikimit, të miratuara sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.” dhe në kundërshtim me Vendimin e KRRTSH Nr.1, datë. 18.06.2003.

-Në 6 raste (5 raste në Shëngjin dhe 1 në Golem) me lejet e legalizimit me nr.700524, datë 26.11.2015, nr.701582, datë 24.04.2017, nr.700563, datë 21.01.2016, nr.700991, datë 18.07.2016, nr.700915, datë 17.06.2016 dhe nr.700995, datë 22.07.2016 janë legalizuar objekte pa respektuar distancat nga bregu i detit, ku nga verifikimi i hartës dixhitale, rezulton se objektet ndodhen në një distancë prej 54m, 75m, 90m, 91m, 95m dhe 96m pranë bregut të detit, pra më pak se distanca e lejuar prej 100 metrash, veprime këto në kundërshtim me Ligjin Nr. 111/2012, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 84, pika a dhe b “Në tokat, pronë private dhe shtetërore, përbri brigjeve të lumenjve, përrenjve, kanaleve, liqeneve, pellgjeve, rezervuarëve, lagunave bregdetare dhe deteve duhet, detyrimisht, të lihet: a) një sipërfaqe toke e lirë për përdorim publik, me gjerësi nga 5 deri në 100 metra nga këto brigje, sipas përkufizimit të bërë në këtë ligj. Gjerësia e saj mund të shtrihet më tej në afërsi të grykës së lumenjve, në rrethinat e ngushta të rezervuarëve ose kur kushtet topografike dhe hidrologjike të lumenjve, liqeneve ose rezervuarëve e bëjnë të nevojshme për sigurimin e njerëzve dhe të pasurisë. Veprimtaritë në këto zona përcaktohen me akte të Këshillit Kombëtar të Ujit; b) një sipërfaqe toke e lirë për zhvillimin e veprimtarive që përcaktohen nga Këshilli Kombëtar i Ujit, me gjerësi nga 100 m deri në 200 m.”

### **C- Për punonjësit e larguar dhe që nuk kanë adresim institucional.**

V. Për 19 ish-punonjësit e me kontrata të përkohshme, për shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimit e tyre. Nga ana jonë në bazë të shkeljeve të konstatuara masa disiplinore, do të ishte nga “Vërejtje” deri në “Largim nga Puna”, përkatësisht për:

1. z. D.K., specialist
2. znj. B.T, specialist
3. znj. E.K, specialist
4. z. G.T, specialist.
5. z. L.D, specialist

6. z. J.K, specialist.
7. z. G.Sh, specialist.
8. z. K.G, specialist
9. z. E.B, specialist
10. z. E.L, specialist
11. z. I.N, specialist
12. z. E.K, specialist
13. z. E.V, specialist
17. z. K.M, specialist
18. z. O.M, specialist
19. z. K.M, specialist
20. z. D.Z, specialist

### **Grupi i Auditimit**

Hysen      **METKO**  
Aleksander **PAPADHIMITRI**  
Orgest     **LEVANI**

---

**Bujar LESKAJ**

**K R Y E T A R**